



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4265 prot.

Himarë, më 12.06 . 2026

VENDIM

Nr. 25, datë 04.06.2026

**“PËR MIRATIMIN E DHËNIES SË DËMSHPËRBLIMIT FINANCIAR PËR STANIN E
Z. LAME BOJKOJ, NË FSHATIN TËRBAÇ TË DËMTUAR
NGA FATKEQËSITË NATYRORE”**

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 54; Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligjin nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”; VKM nr. 747, datë 20.11.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile”; VKM nr. 923, datë 25.11.2020 “Për funksionimin dhe organizimin e Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe strukturave të sistemit të mbrojtjes civile”; VKM nr. 835, datë 03.12.2004 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Emergjencat Civile”; si dhe VKM nr. 329, datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”;

Në përgjigje të kërkesës nr. 58 prot., datë 06.02.2026, paraqitur nga z. Lame Bojkoj pranë Njesisë Administrative Horë–Vranisht dhe të përcjellë pranë Bashkisë Himarë me shkresën nr. 1300 prot., datë 19.02.2026, me objekt: “Kërkesë për ngritjen e një grupi pune për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara në stallën e bagëtive si pasojë e kushteve të këqija atmosferike (erë e fortë dhe reshje të vazhdueshme)”, shkresës nr. 1300/1 prot., datë 19.03.2026 me objekt: “Kërkesë për plotësimin e dokumentave të kërkesës time në datë 18.02.2026, me nr. 1300/1”; Në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”; të VKM nr. 835, datë 03.12.2004 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”; procesverbalit të grupit të punës, i përbërë nga z. Dionis Kapaj, znj. Eliona Cacaj dhe z. Ervin Shkurta me datë 10.02.2026; shkresës përcjellëse nr. 1300 prot., datë 19.02.2026 e Njesisë Administrative Horë–Vranisht; shkresës për plotësim dokumentacioni nr. 1300/1 prot., datë 19.03.2026; kontratës së qirasë nr. 944 prot., datë 04.02.2026, në emër të z. Lame Bojkoj; certifikatës shëndetësore veterinarë e bagëtive; procesverbalit të konstatimit nr. 1300/2 prot., datë 30.03.2026 si dhe shkresës nr. 1300/3 prot., datë 30.03.2026 me objekt: “Dërgim informacioni për stanin e dëmtuar në fshatin Tërbaç”;

Këshilli Bashkiak Himarë në mbledhjen e tij të datës 04.06.2026 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga drejtoria e mbrojtjes së territorit dhe emergjencave civile, për

miratimin e dhënies së dëmshpërblimit financiar për dëmtimin e banesës së z. Lame Bojkoj, në fshatin Tërbaç, të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore, vendosi me 18 vota pro, 0 kundër, 0 abstenim,

VENDOSI:

1. Të miratojë dhënien e dëmshpërblimit financiar për stanin e z. Lame Bojkoj, në fshatin Tërbaç, të dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore”
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Bashkia Himarë, drejtoritë dhe strukturat përgjegjëse të ngarkuara për këtë çështje.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55, pika 6.

KRYETARI

Dhimitër Kapaj

